



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË

NJOFTIM

PËR PËRFUNDIMIN E HETIMEVE

Në Tiranë, sot më datë 09.05.2022, unë Bledar Valikaj, prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, i njoftoj përfundimin e hetimeve të pandehurve:

1. **Eni Qirjako**, atësia Viktor, amësia Alba, datëlindja 15.04.1997, lindur ne Vlore e banues ne Tirane, Rr. "Myslym Shyri", Pallati nr.11, shkall.1, apar 4, kombësia Shqiptar, shtetësia Shqiptar, arsimi i larte, gjendja familjare beqare, e pa dënuar, identifikuar me numër te kartës se identitetit J75415102U.

2. **Andi Agaraj**, i biri i Fetah dhe Hasie, i datëlindjes 29.03.1990, lindur ne Ballsh dhe banues ne rrugën "Ismail Qemali", Nd 20, h43, ap 30, Yzberish – njësia administrative 14, bashkia Tirane, me kombësi shqiptare dhe shtetësi shqiptar, me arsim te larte, profesioni IT, me gjendje gjyqësore i padënuar, me gjendje civile beqar, dokument identifikues me nr. ID J00329081U.

3. **Klodian Sota**, atësia Petrit, amësia Flutura, datëlindja 16.04.1979, lindur ne Lushnje e banues ne Tirane, Rr. "Medar Shtylla", Pallati nr.30, shkall.2, apar 56, kombësia Shqiptar, shtetësia Shqiptar, arsimi i larte, gjendja familjare i martuar, i pa dënuar, identifikuar me numër te kartës se identitetit H90416056H.

4. **Endri Ikonomi**, atësia Rudi, amësia Elira, datëlindja 28.02.1976, lindur e banues ne Tirane, Rr. "Nikolla Tupe", Pallati nr.6, shkall.2, ap 12, kombësia shqiptar, shtetësia shqiptar, arsimi i larte, gjendja familjare i martuar, i pa dënuar me pare, identifikuar me numër te kartës se identitetit ID H60228160A.

Në përfundim të hetimeve paraprake të procedimit penal nr.9428 të vitit 2021, ka rezultuar se:

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ne date 22.12.2021, ka regjistruar kryesisht procedimin penal nr.9428, dhe po zhvillohen hetime, pasi dyshohet se janë konsumuar elemente te veprës penale te "Ndërhyrja ne te dhënat kompjuterike", "Ndërhyrja ne sistemet kompjuterike" si dhe "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar ne nenin 293/b, 293/c dhe 248 te K. Penal.

Objekti i hetimit lidhet me faktin se ne rrjetet sociale ne date 22.12.2021, e konkretisht nëpërmjet aplikacionit "Wastap", është publikuar një raport ne programin exel, lidhur me listë pagesat e muajit Janar te vitit 2021, te pagave te punonjësve te punësuar ne institucionet shtetërore dhe private. Këto te dhëna janë shpërndarë fillimisht nëpërmjet aplikacionit "Watsap" dhe pastaj janë publikuar dhe ne media. Këto te dhëna janë lehtësisht te aksesueshme nga çdo shtetas.

Me urdhrin e datës 23.12.2021, Prokuroria Pranë Gjykatës se Shkalles se Par Tirane, ka urdhëruar mbajtësin (administratorin) ose kontrolluesin, e te dhënave kompjuterike te Agjencisë Kombëtare te Shërbimit te Informacionit te dorëzojë te dhënat kompjuterike te memorizuara ne sistemin kompjuterik e konkretisht te te gjitha logeve qe kane loguar ne sistemin e te dhënave për pagat Janar 2021. Urdhër i cili është ekzekutuar nga policia gjyqësore me proces verbal përkatës te datës 23.12.2021.

Me urdhrin e datës 23.12.2021, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkalles së Parë Tirane, ka urdhëruar mbajtësin (administratorin) ose kontrolluesin, e të dhënave kompjuterike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tirane, të dorëzojë të dhënat kompjuterike të memorizuara në sistemin kompjuterik, e konkretisht të të gjitha logeve që kanë loguar në sistemin e të dhënave për pagat Janar 2021. Urdhër i cili është ekzekutuar nga policia gjyqësore me proces verbal përkatës të datës 23.12.2021.

Me urdhrin e datës 23.12.2021, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkalles së Parë Tirane, ka urdhëruar mbajtësin (administratorin) ose kontrolluesin, e të dhënave kompjuterike të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tirane, të dorëzojë të dhënat kompjuterike të memorizuara në sistemin kompjuterik e konkretisht të të gjitha logeve që kanë loguar në sistemin e të dhënave për pagat Janar 2021. Urdhër i cili është ekzekutuar nga policia gjyqësore me proces verbal përkatës të datës 23.12.2021.

Nga aktet hetimore paraprake të administruara rezultojnë se shtetësia e dyshuara Eni Qirjako, ka filluar punë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve më 20 Korrik 2020, në pozicionin e specialistit IT. Ajo ka rënë në dijeni të shpërndarjes së të dhënave të pagave në datë 22.12.2021. Pasi është njohur me këto të dhëna, ka konstatuar se ora dhe data e krijimit të file-it në Excel përkonte me datën dhe orën që këto të dhëna ajo ja kishte dërguar kolegut të sajë shtetasit Andi Agaraj. Lidhur me këtë faktë siç rezultojnë edhe nga aktet, e dyshuara ka njoftuar eprorin e sajë, drejtorin Ervin Muca, të cilit i ka bërë të qartë faktin se emri i userit nga i cili kanë dalë këto të dhëna me emrin "Moza Seraj", është useri që ajo përdor në aksesimin e të dhënave nga ana e sajë. Nga shtetësia Eni Qirjako është kërkuar ndryshimi i userit me emrin "Moza Seraj", dhe nuk është bërë. Gjithashtu nga aktet hetimore është konstatuar se me procesverbalin e sekuestrimit të datës 23.12.2021, policia gjyqësore ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale hard diskun e kompjuterit të specialistes së IT Eni Qirjako në zyrën e sajë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Prova materiale e sekuestruar është evidentuar me këto të dhëna Hard disk me PO 301020152 DHE SERVIS CODE :36103764782, me kapakë ngjyre të zeze gjithsej 1 (një) cope.

Nga aktet hetimore e konkretisht referuar procesverbalit të këqyrjes së E-mailit të punës të specialistes së IT në DPT Eni Qirjako, janë konstatuar se të dhënat e kërkuar dhe të publikuara objekt hetimi, janë dërguar nga E-maili i sajë i punës, në E-mailin e punës së shtetasit Andi Agaraj në datat e mëposhtme:

Në datë 21.10.2020, listë pagesat e muajit shtator 2020. Në datë 25.11.2020, listë pagesat e muajit tetor 2020. Në datë 25.01.2021, listë pagesat e dhjetorit 2020. Në datë 24.02.2021 listë pagesat e janarit 2021. Me datë 29.04.2021 listë pagesat e muajit mars dhe në datë 22.10.2021 listë pagesat e muajit shtator 2021. Këto të dhëna i janë dërguar nga adresa zyrtare e punës eni.qirjako@akshi.gov.al në adresën e andi.agaraj@akshi.gov.al. Këto file siç rezultojnë nga këqyrja janë dërguar në programin we transfer.

Në kuadër të këtij procedimi penale, është kërkuar kryerja e ekspertimit të kompjuterëve të sekuestruar me posedues shtetasit Andi Agaraj e Eni Qirjako. Si dhe hark diskut sekuestruar shtetasit Klodian Sota.

Referuar aktit të ekspertimit me nr.259 Prot date 22.02.2022, nga ekzaminimi e WD me nr. Serie. WXU1E29DSDVT, sekuestruar shtetasit Klodian Sota, eksperti ka arritur në konkluzionin se : ***-Në hard diskun e jashtëm i markës "WD, s/n: WXU1E29DSDVT" objekt ekspertimi, sekuestruar shtetasit Klodian Sota, u konstatuan shtatë skedarë dokumenta të formatit "Excel" që përmbajnë të dhënat e kërkuara në vendimin e ekspertimit, ku në to gjenden pagat e shtetasve të ndryshëm, si dhe në kokat e kollonave gjenden disa nga emërtimet si; Numri personal, emri, mbiemri, periudha, isAlbanian, NIPT, subjekti, RetunDate, DRT, DaysWorked, paga bruto, paga kontribute, kontributet shoqërore, kontribute punëdhënësi, kontribute punëmarrësi, kontribute suplementare, kontribute shëndetësore, TAP, profesioni, Kategoria dhe tipi i biznesit, siç janë shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.***

-Të gjithë skedarët dokumenta të formatit "excel" të ruajtura në hard diskun e jashtëm objekt ekspertimi, sëbashku me raportet e metadatave të tyre, ju vihen në dispozicion në hard diskun e jashtëm të markës "Verbatim, me nr. s/n:53194103883301522, ITB" bashkëlidhur aktit të ekspertimit, në dosjen me emërtimin; 1-Skedarët dokumenta të formatit Excel

-Në hard diskun objekt ekspertimi, u konstatua një dokument me emrin "29.04.2021.xlsx", i cili është identik me një dokument të rikuperuar në kompjuterin e sekuestruar shtetasit "Andi Agaraj", pasi kanë vlerat hash MD5 dhe SHA1 të njëjta, siç janë shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Gjithashtu në hard diskun objekt ekspertimi, përveç dokumentave që përmbajnë fjalët e vëna në dispozicion në vendimin e ekspertimit, u konstatua edhe një numër i konsiderueshëm dokumentash të tjerë me të dhëna bankare për klientë të ndryshëm.

Të gjithë skedarët dokumenta të konstatuara në hard diskun objekt ekspertimi, sëbashku me raportet e metadatave të tyre, ju vihen në dispozicion në hard diskun e jashtëm të markës "Verbatim, me nr. s/n:53194103883301522, ITB" bashkëlidhur aktit të ekspertimit, në dosjen me emërtimin; 2-Skedarët dokumenta të konstatuara në hard disk_portable dhe 3-Skedarët dokumenta të konstatuara në hard disk_html

Të dhënat ju vihen në dispozicion në formate "Excel", në formatin ".html" i cili mund të lexohet me shfletuesit "Google Chrome" ose "Internet Explorer", si dhe në formatin "portable" për të cilin duhet të hapet skedari "OpenCase.bat" që gjendet brenda folderit.

Referuar aktit të ekspertimit me nr.256 Prot date 22.02.2022, nga ekzaminimi i kompjuterit të shtetasit Andi Agaraj, eksperti ka arritur në konkluzionin se :

-Në lidhje me pyetjen e parë dhe të dytë, në njësinë kompjuterike të markës Lenovo, model: ThinkStation P310, me nr.serie s/n: S4Y86137 objekt ekspertimi, sekuestruar shtetasit Andi Agaraj, u rikuperuan disa skedarë dokumenta të formatit "Excel" që përmbajnë të dhënat e kërkuara në vendimin e ekspertimit, ku në tabelat e formatit "excel" gjenden pagat e shtetasve të ndryshëm, si dhe në kokat e kollonave gjenden disa nga emërtimet si; Numri personal, emri, mbiemri, periudha, isAlbanian, NIPT, subjekti, RetunDate, DRT, DaysWorked, paga bruto, paga kontribute, kontributet shoqerore, kontribute punëdhënësi, kontribute punëmarrësi, kontribute suplementare, kontribute shëndetësore, TAP, profesioni, Kategoria dhe tipi i biznesit, siç janë shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Të gjithë skedarët dokumenta të ruajtur, si dhe ato të formatit "excel" të rikuperuara nga memoria e njësisë kompjuterike objekt ekspertimi, sëbashku me raportet e metadatave të tyre, ju vihen në dispozicion në hard diskun "Verbatim, me nr. s/n:53194103883301522, ITB" bashkëlidhur aktit të ekspertimit, në dosjet me emërtimet; 1-Skedarët dokumenta të konstatuara në kompjuter, 2-Të dhënat e skedarëve+akviteti i përdoruesit-html dhe 3- Të dhënat e skedarëve +akviteti i përdoruesit-Portable

-Në lidhje me pyetjen e tretë, në njësinë kompjuterike objekt ekspertimi, për datat 21.10.2020, 24.02.2021 dhe 29.04.2021, u rikuperuan dokumenta të formatit "Excel" që përmbajnë në kokat e kollonave të tyre të dhënat e kërkuara në pyetjen e parë të vendimit të ekspertimit, siç janë pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Për datën 21.10.2020, në kompjuterin objekt ekspertimi është aksesuar një dokument i formatit "Excel", me emërtimin "21.10 Listepagesat Total.xlsx", me të dhënat e kërkuara, siç është shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Për datën 24.02.2021, nga të dhënat e fshira u rikuperua një dokument i formatit "Excel" i cili përmban të dhëna në lidhje me pagat e shtetasve të ndryshëm dhe përmban në kokat e kollonave disa nga emërtimet e kërkuara në vendimin e ekspertimit, si dhe po në këtë datë përdoruesi ka aksesuar tre dokumenta me emrat "24.02 - 2101.xlsx", " 25.01 .xlsx" dhe "24.02 Listepagesat 2101.xlsx", siç është shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Për datën 29.04.2021 në hard diskun sekuestruar shtetasit "Klodian Sota" dërguar për ekspertim me Vendimin e Ekspertimit të datës 31.12.2021, u konstatua një dokument i formatit "excel" me emrin "29.04.2021.xlsx", i sjellë në këtë hard disk me datë 30.04.2021, ora 09:10:07.

Ky dokument është identik me dokumentin e datës 29.04.2021 i rikuperuar nga kompjuteri objekt ekspertimi, pasi kanë vlerat hash MD5 dhe SHA1 të njëjta, siç janë shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Gjithashtu në datën 29.04.2021 përdoruesi ka aksesuar serverin e email-it me adresë 10.253.3.3/ , por nuk mund të identifikohen veprimet e kryera prej tij.

-Për datat 25.11.2020, 25.01.2021 dhe 22.10.2021, nuk u konstatuan dhe nuk u arrit të rikuperohen skedarë dokumenta që në përmbajtjen e tyre të gjenden të dhënat e kërkuara në pyetjen e parë të vendimit të ekspertimit.

-Në lidhje me dokumentat e vëna në dispozicion bashkëlidhur vendimit të ekspertimit, kemi një email që mban datën 29.04.2021, me dërgues "Eni Qirjako" dhe marrës Andi.Agaraj@akshi.gov.al, ku në përmbajtje të emaili-t kemi linkun: <https://we.tl/t-YVDHZJeqtm>.

Nga analizimi i historisë së navigimit të përdoruesit të kompjuterit në internet, u konstatua se në këtë kompjuter rezulton se përdoruesi e ka naviguar linkun: <https://we.tl/t-YVDHZJeqtm>, pasi kur kjo adresë u vendos në internet ajo të drejton tek një link tjetër me adresë <https://wetransfer.com/downloads/ee82364572327169425874aa5e99e3652021042909124211faa9e>, i cili është vizituar në kompjuterin objekt ekspertimi, me datë 29.04.2021, ora 14:23:05, siç është shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Në lidhje me adresat e tjera të vëna në dispozicion në dokumentat bashkëlidhur vendimit të ekspertimit, kur u vendosën në internet u përfatuan adresat që i përkasin serverit "wetransfer.com", por nuk u konstatuan dhe nuk u arrit të rikuperohen të dhëna që ju përkasin adresave dhe datave të përshkruara në dokumentat bashkëlidhur, siç janë shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Në lidhje me e-mailet e marra apo të dërguara, emailët nuk ruhen lokalisht në kompjuter por në serverin me adresë "10.253.3.3/".

-Në lidhje me aktivitetin e përdoruesit në internet dhe faqet internetit të naviguara apo aksesuara nga përdoruesi konstatohet se historia e navigimit në internet është fshirë dhe fshirja e saj duhet të jetë bërë nga përdoruesi në datat 22 ose 23.12.2021.

-Të gjithë skedarët e formatit "excel" të rikuperuara nga memoria e njësisë kompjuterike objekt ekspertimi, sëbashku me raportet e metadatave të tyre, ju vihen në dispozicion në hard diskun "Verbatim, me nr. s/n:53194103883301522, 1TB" bashkëlidhur aktit të ekspertimit, në dosjet me emërtimet; 4-Skedarët e formatit Excel të rikuperuara sipas datave dhe 5-Skedarë Exel i rikuperuar me MD5 të njëjtë.

Të dhënat ju vihen në dispozicion në formate "Excel", në formatin ".html" i cili mund të lexohet me shfletuesit "Google Chrome"ose "Internet Explorer", si dhe në formatin "portable" për të cilin duhet të hapet skedari "OpenCase.bat" që gjendet brenda folderit.

Referuar aktit të ekspertimit me nr.255 Prot date 22.02.2022, nga ekzaminimi i kompjuterit të shtetasit Eni Qirjako, eksperti ka arritur në konkluzionin se :

-Në lidhje me pyetjen e parë dhe të dytë, në njësinë kompjuterike të markës "DELL, model: PRECISION T1700, me nr. Express Service Tag: 36103764782" objekt ekspertimi, sekuestruar shtetas Eni Qirjako, u konstatuan dhe u rikuperuan disa skedarë dokumenta të formatit "Excel" që përmbajnë të dhënat e kërkuara në vendimin e ekspertimit, ku në tabelat e formatit "excel" gjenden pagat e shtetasve të ndryshëm, si dhe në kokat e kollonave gjenden disa nga emërtimet si; Numri personal, emri, mbiemri, periudha, isAlbanian, NIPT, subjekti, RetunDate, DRT, DaysWorked, paga bruto, paga kontribute, kontributet shoqerore, kontribute punëdhënësi, kontribute punëmarrësi, kontribute suplementare, kontribute shëndetësore, TAP, profesioni, Kategoria dhe tipi i biznesit, siç janë shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Në lidhje me pyetjen e tretë, në njësinë kompjuterike objekt ekspertimi, për datën 24.02.2021, u konstatua një dokument me emërin "RROGAT JANAR 2021.xlsx", i cili përmban në kokat e kollonave të tij të dhënat e kërkuara në pyetjen e parë të vendimit të ekspertimit, si; Numri personal, emri, mbiemri, periudha, isAlbanian, NIPT, subjekti, RetunDate, DRT, DaysWorked, paga bruto, paga kontribute, kontributet shoqerore, kontribute punëdhënësi, kontribute punëmarrësi, kontribute suplementare, kontribute shëndetësore, TAP, profesioni, Kategoria dhe tipi i biznesit.

Ky dokument është shkarkuar në kompjuter me datë 22.12.2021 por në metadatave të brendshme të tij rezulton se ai është krijuar si dokument me datë 24.02.2021, ora 10:33:44, me autor "PC" dhe autor i fundit "ADMIN", siç është shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Nga ky kompjuter u rikuperuan edhe pjesë dokumentash të formatit Excel që i përkasin datës 23.02.2021 që kanë kolona me emërtime si ato të përshkruara në vendimin e ekspertimit por që janë sipas qarqeve.

-Në kompjuterin sekuestruar shtetasit "Andi Agaraj" është rikuperuar një dokument i formatit "Excel" që mban datën 24.02.2021. Të dy dokumentat e mësipërm kanë të njëjtën datë krijimi për herë të parë dhe të njëjtin autor por ndryshojnë për nga madhësia.

Në lidhje me përmbajtjen e tyre, këto dokumenta megjithëse kanë ndryshime sa i përket formatimit të renditjes së emrave dhe numrit të kolonave, nga testimi i disa emrave rezulton përputhje e plotë e të dhënave në kolona të ndryshme.

-Në lidhje me dokumentat e vëna në dispozicion bashkëlidhur vendimit të ekspertimit, për datën 24.02.2021 përdoruesi i këtij kompjuteri ka vizituar faqen e internetit/serverin "Wetransfer", pasi në kompjuter kanë rënë disa skedarë që njihen me emrin "cookies".

-Gjithashtu në kompjuter u rikuperua një link me adresë <https://we.tl/t-4typNjkFvE>, që është identik me linkun e pasqyruar në një email të dërguar nga shtetasja "Eni Qirjako" drejt shtetasit "Andi Agaraj" me adresë email-i Andi.Agaraj@akshi.gov.al me datë 24.02.2021, bashkëlidhur vendimit.

-Për datën 22.10.2021, u rikuperuan disa dokumenta të formatit "Excel" të cilat kanë përmbajtje si ato të kërkuara, siç është shpjeguar dhe pasqyruar për ilustrim në pjesën ekzaminative.

-Për datat 21.10.2020, 25.11.2020, 25.01.2021, 29.04.2021, nuk u konstatuan dhe nuk u arrit të rikuperohen skedarë dokumenta që në përmbajtjen e tyre të gjenden të dhënat e kërkuara në pyetjen e parë të vendimit të ekspertimit.

-Në lidhje me historinë e navigimit në internet të këtij kompjuteri për shfletuesin "Google Chrome" kjo histori është e fshirë përpara datës 27.09.2021, ndërsa ajo e shfletuesit "Mozilla FireFox" fillon me date 27.10.2021.

-Në lidhje me komunikimet email të adresës eni.qirjako@akshi.vov.al, ky email nuk ruhet lokalisht në kompjuter por në serverin me adresë "<https://owa.e-albania.al/owa/>"

-Të gjithë skedarët dokumenta të ruajtur, si dhe ato të formatit "excel" të rikuperuara nga memoria e dy hard disqeve të njësisë kompjuterike objekt ekspertimi, sëbashku me raportet e metadatave të tyre, ju vihen në dispozicion në hard diskun "Verbatim, me nr. s/n:53194103883301522, 1TB" bashkëlidhur aktit të ekspertimit, në dosjet me emërtimet; 1-Të dhënat e hard diskut të parë_storage, 2-Të dhënat e hard diskut të dytë_OS dhe 3-Skedari me emërtimin_RROGAT JANAR 2021.xlsx.

Në këto kushte, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë do të procedohet me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq ndaj këtij të pandehurve:

Eni Qirjako, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimit të detyrës", kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 e 25 i K. Penal.

Andi Agaraj, akuzuar për veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 e 25 i K. Penal, "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 259 i K. Penal.

Klodian Sota, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsionit aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike", "Korrupsioni pasiv në sektorin privat" parashikuar nga nenet 164/b e 244 i K. Penal.

Endri Ikonomi, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsion pasiv në sektorin privat" parashikuar nga neni 164/b i K. Penal.

Sa më sipër, në bazë të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, krahas njoftimit për përfundimin e hetimeve, i komunikoj të pandehurit/mbrojtësit të drejtat si më poshtë:

1. Të njihet me aktet e të marrë kopje.
2. Brenda 10 ditëve të paraqesë memorie e dokumente.
3. T'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë.
4. Të bëjë deklaratime apo të kërkojë të merret në pyetje.

PROKURORI
BLEDAR VALIKAJ